



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 930/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Pejë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Prishtinë, për shkak të mospërputhjes së rezultatit në Vendvotimin (VV) 1711C/01R, në Komunën e Pejës, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Pejë.

### Arsyetim

PZAP-i, më datën 15.11.2013, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se duke u bazuar në të dhënat e vëzhguesve të LDK-së, në Qendrën e Votimit 1711C/01R, ku në bazë të procesverbalit të vëzhguesit të LDK-së, në këtë vendvotim subjekti politik AAK, përkatësisht kandidati Ali Berisha ka marrë 94 vota, ndërsa në bazë të rezultateve zyrtare të KQZ-së, në këtë VV janë publikuar 140 vota, ku dallimi është 46 vota në favor të kandidatit të AAK-së Ali Berisha, si dhe kemi rënie të votave për kandidatin e PDK-së, Muhamet Halitaj dhe atë të LVV-së Hivzi Muharremi.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës si dëshmi: Rezultatet zyrtare të Qendrës së Votimit 1711C/01R, dhe Procesverbalin e subjektit të LDK-së, në Qendrën e Votimit 1711C/01R.

PZAP-i, më datë 16.10.2013, në bazë të nenit 117.2 dhe 117.4 të LZP-së, dhe nenit 12 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), materialin zgjedhor si: Lista përfundimtare e votuesve (LPV), Formularët e Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formularin e Rezultateve për Kandidat (FRK), dhe Librin e Vërejtjeve (LV), për VV 1711C/01R, PZAP, ka pranuar materialin zgjedhor të kërkuar nga KQZ në të njëjtën datë, si dhe ka shqyrtuar dhe hetuar materialin zgjedhor dhe pretendimet ankimore, provat që gjendet në shkresat e

lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara ka gjetur se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore nga ana e LDK-së, se në VV 1711C/01R, në Komunën e Pejës, ka mospërputhje të rezultatit, PZAP-i, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar ngase duke u nisur nga fakti se në bazë hetimit dhe shqyrtimit të materialit zgjedhor, PZAP nuk ka gjetur parregullsi dhe gabime ose mospërputhje siç pretendohet në ankesë, e meqenëse hetimet nuk vërtetuan ekzistimin e shkeljeve që do të ndikonin në rezultatin e përgjithshëm, e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 930/2013 më datën 18.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.